



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË SEMINARIN XIV PËR MËSIMIN PLOTËSUES NË GJUHËN SHQIPE NË DIASPORË, “TIRANA 2018”

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës, do të organizojnë seminarin XIV për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë.

Duke u mbështetur në kalendarët shkollorë të shteteve të ndryshme dhe për të mundësuar pjesëmarrje të gjerë të mësuesve të diasporës, seminari i këtij viti do t'i zhvillojë punimet në datat **31 korrik-03 gusht 2018**, në qytetin e Tiranës.

Mësues/et/it e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, të cilët duan të marrin pjesë në këtë seminar për zhvillimin e tyre profesional, duhet të aplikojnë **deri më 15 maj 2018** në linkun:

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSf4I4RANRXMY_5DHikP2h911QS6uf0IXhte9i2o13NGLMUww/viewform

Pasi klikohet linku, hapet fletëthirrja ku çdo aplikant duhet të plotësojë të dhënat e kërkuara. Pas plotësimit, kontrollohen dhe njëherë të dhënat dhe jepet SUBMIT (në fund të formularit).

Të dhënat më pas i shkojnë automatikisht personave të cilët janë vendosur për menaxhimin e listës.

Konfirmimi për pranimin e prezantimit/kumtesës do të bëhet deri më **15 qershor 2018**

Përmes prezantimeve të ndryshme dhe punës konkrete në grupe pune, dy tema bosht do ta karakterizojnë edicionin e sivjetshëm:

1. Mësimi i integruar (ndërlëndor)
2. Gjuha standarde dhe dialektet

Lidhur me këto dhe tema të tjera të fushës së metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies e të nxënies nga lëndët gjuhë shqipe e letërsi shqiptare, histori dhe gjeografi, trashëgimi kulturore dhe artistike etj., pedagogjisë ndërkulturore, mësimi kontrastiv (ndërmjet gjuhësh, kulturash etj.), mësimi të diferencuar etj., në seminar do të angazhohen ligjërues/lektorë shqiptarë (punonjës shkencorë, specialistë dhe ekspertë të arsimit, titullarë dhe zyrtarë shteti) si dhe të paktën një ligjërues i huaj nga qarqet përkatëse profesionale të ndonjërit prej shteteve ku zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe.

Po ashtu, pritet që një pjesë shumë të çmuar të programit ta përbëjnë prezantimet-ligjëratat profesionale të vetë mësuesve e të mësuesve që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë në diasporë.

Paraqitja dhe dërgimi i punimit të propozuar:

Për të dërguar propozimin për prezantim/kumtesë në seminar do të aplikoni në linkun:...

<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdaJB-11sgsv9c0UMiGZd1OGjxEccHgJFhd5aSW03tUOgA21w/viewform>

Edhe në këtë formular, ashtu si dhe në formularin e parë, plotësimi i të dhënave bëhet për çdo aplikant më vete. Pas plotësimit klikohet përsëri butoni SUBMIT dhe të dhënat i shkojnë personave të vendosur për menaxhimin e listës.

Afati për konfirmimin e paraqitjes me prezantime/kumtesa është deri më **15 maj 2018**. Konfirmimi për pranimin e prezantimit/kumtesës do të bëhet deri më **15 qershor 2018**. Prezantimet nuk duhet të zgjasin më shumë se 30 minuta.

Të tjera:

- Meqë pjesa kryesore e seminarit do të zhvillohet në grupe pune tematike më të vogla (punëtori-Workshope), janë të mirëpritura edhe propozime për aktivitete të ndryshme profesionale.
- Brenda datës **15 maj 2017** të paraqiten edhe propozimet për promovime krijimesh autoriale në fushat me interes didaktik; tekste e mjete mësimore, materiale e produkte të tjera konkrete me interes mësimor etj.
- Edhe këto propozime të paraqiten duke aplikuar në linkun: <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdaJB-11sgsv9c0UMiGZd1OGjxEccHgJFhd5aSW03tUOgA21w/viewform>
- Konfirmimi për pranimin e promovimit do të bëhet deri më **15 qershor 2018**.
- Deri në datën **01 korrik 2018** do t'ju dërgojmë programin e plotë të seminarit.
- Personat që do të menaxhojnë listat e pjesëmarrësve mësues dhe të pjesëmarrësve referues do të jenë:
 - Znj. Anila Ferizaj, MASR, Shqipëri
 - Z. Nuhi Gashi, MASHT, Kosovë

Konfirmimi për pjesëmarrje në seminar si mësues ose si referues do të realizohet nga të dy përfaqësuesit e ministrive përkatëse, z. Nuhi Gashi dhe znj. Anila Ferizaj.